



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 09, Datë 23.01.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “f”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.01.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/2 prot., datë 18.01.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 67 prot., datë 10.01.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “G.S.K” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.4, gërmat “a”, “b” dhe “d”. Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penalitetit) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në formatin original/ fotokopje të njësuar me origjinalin strukturën organizative të saj dhe gjithashtu të depozitojë në ERE informacion mbi stafin teknik të kësaj strukture që do të angazhohet me veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat e saktësuara të vitit 2020 dhe të përcjellë në format original/fotokopje të njësuar me origjinalin pasqyrat financiare për vitin 2021. Gjithashtu shoqëria duhet të dokumentojë/depozitojë në ERE kontratën e Huasë/Kontratën e kredisë, sikurse parashikuar në planin e biznesit, për të mbuluar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën një muaj.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike;

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në formatin original ose fotokopje e njësuar me origjinalin kontratën e qirasë për disponimin e ambientit për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike. Po ashtu, duke qenë se afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, do të saktësohet me shoqërinë, nëse ky do të jetë dokument i përkohëshëm që shërben vetëm për momentin e aplikimit deri në përfundim të afatit të kontratës apo do të sjellë një kontratë qiraje që do të mbulojë të gjithë periudhën 5-vjecare të licencimit.
- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI